



Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPBSL)

29 maj 2018 - 14.00 -16.00

Zyra e BE-së në Kosovë/Përfaqësuesja Speciale e BE-së
Salla e konferencave, kati i parë

Konkluzionet e përbashkëta

Zj. Nataliya Apostolova (Shefe e Zyrës së BE-së/Përfaqësuese Speciale e BE-së)

Zj. Alexandra Papadopoulou (Shefe e Misionit EULEX)

Z. Abelard Tahiri, Ministër (Drejtësisë, MD)

Z. Blerim Isufaj, Kryesues (Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK)

Z. Nehat Idrizi, Kryesues (Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK)

Konkluzioni i përbashkët 1: Raporti i KE-së për Kosovën 2018

Bordi i pranon gjetjet e Raportit për Kosovën 2018 dhe zotohet se do të punojë bashkë për të përmbushur rekomandimet e përmbajtura në të.

Konkluzioni i përbashkët 2: Agjenda e Reformës Evropiane (ARE)

Bordi i pranon të arriturat e fundit legislative të autoriteteve të Kosovës ne fushën e sundimit të ligjit, që kanë të bëjnë me ARE. Në të njëjtën kohë, Bordi insiston që dispozitat ne lidhje me



suspendimin dhe largimin e zyrtarëve publik të miratohen dhe të zbatohen në praktikë sa më shpejt.

Konkluzioni i përbashkët 3: Gjyqësori

Bordi pajtohet që rritja e numrit të zyrtarëve ligjor dhe bashkëpunëtorëve profesional në gjykata dhe prokurori ka rëndësi të madhe dhe se për këtë qëllim duhet ndarë buxhetin e duhur.

Për më tepër, Bordi gjithashtu i bën thirrje Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të finalizojë shpejt procesin e miratimit të rregulloreve të mbetura.

Bordi gjithashtu pajtohet mbi rëndësinë e integritit të gjyqësorit, ku me përkthimin adekuat të dokumenteve dhe trajnimin e gjykatësve, prokurorëve dhe stafit të tyre në veri do të përmbillet procesi i integritit. Bordi u pajtua që, duke e marrë parasysh numrin aktual të lëndëve të pazgjidhura, Gjykata Themelore në Veri do të ketë nevojë për më shumë mbështetje nga të gjitha institucionet.

Konkluzioni i përbashkët 4: Çështjet legjislative

Bordi njeh rëndësinë e të ashtuquajturës pako e ligjeve për gjyqësorin, si dhe domosdoshmërinë për të përfunduar shpejt punën në të, duke marrë në konsideratë mendimet e të gjitha grupeve të interesit.

Për më tepër, Bordi pajtohet mbi domosdoshmërinë për ta miratuar shpejt Kodin Penal, si dhe për ta intensifikuar punën në Kodin e Procedurës Penale.

Ne fund, bordi thekson domosdoshmërinë për të miratuar të ashtuquajturën pako të ligjeve kundër korrupsionit, duke i dhënë prioritet Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskim.

Konkluzioni i përbashkët 5: Rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit



Bordi pajtohet mbi rëndësinë e rishikimit funksional të udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë, por në të njëjtën kohë vlerëson se metodologjinë e përdorur duhet rishikuar, për t'i arritur rezultatet e pritura në mënyrë më efikase dhe në kohë më të shkurtër.

Autoritetet e Kosovës duhet t'i përdorin konkluzionet e Rishikimit funksional për të arritur progres të mëtjshëm dhe më të shpejt në rrugën e tyre evropiane.

Konkluzioni i përbashkët 6: Gjendja aktuale e Udhërrëfyesëve

Bordi mirëpret progresin e arritur në Udhërrëfyesin për Panelin e Ankesave të AKP-së. Funksionaliteti i Panelit do t'ia lejojë Kosovës që t'i lërë pas vetës çështjet pronësore të lidhura me konfliktin.

Më tej, Bordi vë në dukje se për sa i përket Udhërrëfyesit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, gjatë muajve të kaluar është bërë mjaft shumë punë në rritjen e efikasitetit të Dhomës. Megjithatë, ka çështje që ende kërkojnë vëmendje nga institucionet e Kosovës, siç janë transformimi i Regjistrisë dhe miratimi i Ligjit mbi Restitucion.

Për sa i përket Udhërrëfyesit për krime lufte, Bordi u bën thirrje Kryesuesit të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit që të përshejtojnë punën në Strategjinë Nacionale për Rastet e Krimeve të Luftës dhe ta përfundojnë atë në bashkëpunim me EULEX-in, para skadimit të mandatit të misionit.